

## URDHËR PROKURIMI

### PROKURIMIN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE NË VLERA TË VOGLA

Unë, Presidentja e Shoqatës Forumi i Gruas Elbasan (FGE), urdhëroj në bazë të rregullores mbi prokurorimet për blerjen me vlera të vogla të hapet procedura për prokurorim në kuadër të projektit “RISE Her /Revitalize Independence and Solid Empowerment for Her i mbështetur nga World Vision Albania përmes fondeve të EU Commission.

Ngarkoj dy persona të stafit me detyrat si më poshtë:

1. **Dhoksa gjoka (Quku)** në pozicion Menaxhere Projekti, do të meret me procedurat e prokurorimit në tërësi dhe do të jetë personi që do të ndjekë të gjithë procesin.
2. **Marsela Muca** Financiere, do të jetë personi që do të meret me verifikimin e të dhënave bankare, kryerjen e pagesave dhe blerjeve të nevojshme.

Të krijohet komisioni për prokurimin i përbërë nga;

- |                        |          |
|------------------------|----------|
| 1. <b>Nertila Toli</b> | Kryetare |
| 2. <b>Soela Kurti</b>  | Anëtare  |
| 3. <b>Mirela Gjoni</b> | Anëtare  |

Ky komision do të funksionojë gjatë gjithë procesit të tenderimit.

**PRESIDENTE**

**SHPRESA BANJA**

## KËRKESE PËR SHPREHJE INTERESI

Për Ekspert i Barazisë Gjinore për projektin:

***“RISE Her /Revitalize Independence and Solid Empowerment for Her”***

zbatuar nga Forumi i Gruas Elbasan i mbështetur nga World Vision Albania përmes fondeve të EU Commission.

Forumi i Gruas Elbasan fton të gjitha personat e interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Ekspert i Barazisë Gjinore.

Ky projekt synon të reduktojë dhunën me bazë gjinore dhe të promovojë barazinë gjinore.

Trajnimi synon të trajnojë anëtarë të komunitetit, përfaqësues të shoqërisë civile, anëtarë të grupeve komunitare mbështetës dhe profesionistë të tjerë e mbi mënyrën e njohjes së shenjave të abuzimit, ofrimin e mbështetjes komunitare për të mbijetuarat dhe raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore tek autoritetet.

### Termet e Referencës për Ekspertin për trajnimin mbi parandalimin e DHBGJ

<b>Programi:</b>	FORUMI I GRUAS ELBASAN
<b>Lloji i shërbimit:</b>	Trajnim mbi parandalimin e DHBGJ
<b>Data:</b>	2024-2026

## **Informacion mbi Forumin e Gruas Elbasan**

Forum i Gruas Elbasan (FGE) është një organizatë që operon në Qarkun e Elbasanit për më shumë se 23 vjet. Organizata ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të grave dhe barazinë gjinore përmes: programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, avokimit; dhunës psiko-sociale-ligjore dhe shërbimeve të tjera alternative.

## **Përshkrimi i programit**

FGE është një nga shoqatat më aktive në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit mbi çështjet gjinore. Shoqata ka realizuar seanca trajnimi për aktorë të ndryshëm lokalë mbi tema të fokusuara në çështjet gjinore, veçanërisht dhunën në familje.

## **Qëllimi i Shërbimit**

FGE (Forum i Gruas Elbasan) është në kërkim të një Eksperti të Kualifikuar dhe me Përvojë për të organizuar 10 ditë trajnimi në 7 bashkitë e Qarkut të Elbasanit.

- Qëllimi i këtij shërbimi është të sigurojë një ekspert për dhunën me bazë gjinore për të organizuar 10 ditë trajnimi me përfituesit në 7 bashkitë e synuara.
- Aktiviteti do të përfshijë përfitues nga 7 bashkitë e Qarkut të Elbasanit.
- Aktiviteti pritet të mbahet në secilën bashki.
- Për aktivitetin kërkohen shërbimet e mëposhtme:
  - Organizimi i aktivitetit për 10 ditë trajnimi,
  - Përgatitja e planit dhe materialeve të nevojshme për trajnimin,
  - Raportimi i aktivitetit – përfundimi i aktiviteteve.

## **Rezultatet e pritura të shërbimit:**

1. Komunitet, profesionistë të trajnuar etj.
2. Sigurimi i mbështetjes më të mirë për mbijetuesit nga komuniteti.
3. Rritja e numrit të rasteve të raportimit të DHBGJ-së tek autoritetet.

## **Roli dhe Përgjegjësitë e ofruesit të shërbimit:**

- Përfundimi i shërbimit të trajnimit.
- Përgatitja e planit dhe materialeve të trajnimit.
- Eksperti i punësuar do të punojë ngushtë me stafin e FGE-së.
- Produkti final do t'i dorëzohet Forumit të Gruas Elbasan në formën e një raporti me foto për çdo ditë trajnimi.
- Organizimi i trajnimit në secilën bashki.

### **Përvoja dhe aftësitë e kërkuara/preferuara të ofruesit të shërbimit:**

- Ekspertizë në trajnimet mbi dhunën me bazë gjinore.
- Të ketë kualifikime specifike në fushën profesionale (me certifikata); përparësi u jepet ekspertëve që kanë përfunduar kualifikime dhe trajnime jashtë vendit ose brenda vendit në fushën e barazisë gjinore dhe buxhetimit gjinor.
- Kërkohet përvoja e mëparshme në moderimin e aktiviteteve. Njohuri në lidhje me punën dhe funksionimin e Forumit të Gruas Elbasan.
- Aftësi të mira komunikimi.

### **Propozimi/Dokumentet e kërkuara për dorëzim dhe kriteret për vlerësim**

Ju lutemi dorëzoni dokumentet e mëposhtme:

1. Një CV
2. Një letër interesi;
3. Shembuj të punëve të mëparshme të ngjashme, Referenca;
4. NIPT, QKR, Licenca
5. Tarifa e konsulencës në total duke përfshirë të gjitha taksat e zbatueshme sipas Ofertës Financiare

**Procedura e aplikimit:** Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentat e mësipërme në E-mail-in zyrtar të FGE-së: [forumigruaselbasan1991@gmail.com](mailto:forumigruaselbasan1991@gmail.com) ose nëpërmjet postës në adresën -Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "Qemal Stafa", Pallati 70, Sh 2, Apt.3.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është 7 Shtator 2024.

### **Vlerësimi Final**

Kontrata do të jepet për propozimin më të pranueshëm teknikisht duke marrë parasysh çmimet e propozuara. Vetëm ofertuesit që kanë kaluar procesin e parakualifikimit të propozimeve teknike dhe administrative do të konsiderohen për vlerësimin e propozimit financiar.

**Shënim:** Të gjitha aplikimet e dorëzuara në një mënyrë tjetër nga ajo e dhënë më sipër nuk do të pranohen.